



EUROPEAN UNION ELECTION OBSERVATION MISSION KOSOVO MUNICIPAL ELECTIONS 2013

KOMUNIKATË PËR SHTYP: MVZBE/2013/01

Bashkimi Evropian fillon Misionin për vëzhgimin e Zgjedhjeve Komunale në Kosovë

Prishtinë, 4 tetor 2013 – Bashkimi Evropian është duke e vendosur Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ i BE) në Kosovë për të vëzhguar Zgjedhjet Komunale, të caktuara për 3 nëntor dhe 1 dhjetor 2013.

MVZ i BE udhëhiqet nga Krye-vëzhguesi Roberto Gualtieri, anëtar i Parlamentit Evropian nga Italia. Gjatë një konference të mbajtur në Prishtinë Gualtieri tha: “Qëllimi ynë është që përmes misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve të mbështesim procesin demokratik dhe të ofrojmë një vlerësim të paanshëm dhe të informuar rreth zgjedhjeve. Shpresojmë se kjo do të përforcojë edhe besimin e votuesve për pjesëmarrje në zgjedhje si dhe të jetë një ndihmesë për krijimin e kushteve më të mira për zgjedhje të drejta dhe gjithëpërfshirëse.”

Misioni përbëhet nga ekipi qendror prej tetë analistëve të zgjedhjeve dhe atyre së shpejti do t’iu bashkohen edhe 20 vëzhgues afatgjatë, të cilët do të vendosen në pjesë të ndryshme të Kosovës deri në përfundim të procesit zgjedhor.

Duke iu afruar ditës së zgjedhjeve, numri i vëzhguesve nga 28 Shtetet Anëtare të BE-së si dhe nga Norvegjia e Zvicra do të rritet në 100, pastaj atyre do t’iu bashkohen edhe 42 vëzhgues afatshkurtër dhe rreth 20 vëzhgues nga ambasadat lokale të BE-së.

MVZ i BE-së, i cili është një trup i pavarur dhe neutral, do të përpilojë një analizë gjithëpërfshirëse mbi procesin zgjedhor, e cila do të bazohet në vëzhgimin afatgjatë dhe metodologjinë e zhvilluar përgjatë shumë viteve si dhe do të vlerësojë se a ishte ky proces në përputhje me standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe me ligjin vendor.

Kjo analizë përfshinë kornizën ligjore, punën e administratës zgjedhore, aktivitetet e fushatës së kandidatëve dhe partive politike, sjelljen e mediave, votimin dhe numërimin, procesin e ankesave dhe parashtrësive si dhe shpalljen e rezultateve.

Deri në këtë pikë, vëzhguesit do të takohen me zyrtarët e qeverisë dhe institucioneve për zgjedhje si dhe përfaqësuesit e partive politike, gjyqësorit, organizatave të shoqërisë civile dhe mediave.

Pas ditës së zgjedhjeve, Krye-vëzhguesi do të lëshojë një deklaratë preliminare me vlerësimet preliminare të MVZ të BE-së rreth këtij procesit. Raporti përfundimtar – së bashku me rekomandimet teknike për zgjedhjet e ardhshme – do të bëhet publik në fillim të vitit 2014.

Mediat duhet t’i drejtojnë pyetjet e tyre tek Florence Marchal, Zyrtare për Marrëdhënie me Media dhe Publik pranë MVZ të BE-së, në +386 49 73 77 08 – florence.marchal@eueomkosovo2013.eu